



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1720/14 Prot.

Tiranë, më 21.10.2019

V E N D I M

Nr. 34 datë 21.10 2019

**MBI MIRATIMIN E TARIFAVE TË APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT, PËR
KURSIN PROFESIONAL PËR PLOTËSIMIN E KREDITEVE PËR ÇERTIFIKIMIN E
UDHËRRËFYESIT TURISTIK**

Në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Statutin UST, të VKM nr. 692 datë 05.10.2016 "Për miratimin e Rregullores për kriteret për pajisjen me çertifikatën për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodi i Etikës", Udhëzimit nr.517 datë 24.01.2017" Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe i kreditimit të programeve për edukimin profesional në vazhdim", në shkresat e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit nr. 585/3 datë 28.02.2019, nr. 2620/1 datë 18.04.2019 "Mbi kërkesën për akreditimin programi" dhe Vendim të Senatit nr. 26 datë 17.05.2019 "Mbi miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të kursit profesional të çertifikimit të udhërrëfyesve të specialiteteve të veçantë", Vendimi i Senatit nr. 38 datë 14.10.2019, shkresat e FVFR, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 21.10.2019,


VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e aplikimit për pjesmarrje në kursin profesional për plotësimin e krediteve për çertifikimin e udhërrëfyesve turistik të specialiteteve të veçantë, në vlerën prej 5000 lekë.
2. Të miratojë tarifën e regjistrimit për pjesmarrje në kursin profesional për plotësimin e krediteve për çertifikimin e udhërrëfyesve turistik të specialiteteve të veçantë, sipas shtojcës 1, bashkëngjitur:
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Vladimir Gjonaj



Shtojca 1

Tarifa e regjistrimit për pjesmarrje në kursin profesional për plotësimin e krediteve për çertifikimin e udhërrëfyesve turistik të specialiteteve të veçantë.

MODULI 1 45000(dyzetepesëmije)lekë

Kacavjerrje malore(Climbing)

Ecje malore (Hiking)

Marshim në mal (Trekking)

Lëvizje me bicikletë në terrene të ndryshme (Biking)

MODULI 2 45000(dyzetepesëmije)lekë

Barkë e vogël dhe e ngushtë me të cilën lundrohet ulur me një lopatë dyshe në ujera të qeta (Kayak)

Lundrim në ujëra të qeta duke qëndruar në këmbë mbi platformë ndihmuar me lopatë (Stand Up Paddle)

Lundrim në lumenj të rrëmbyer (Rafting)

MODULI 3 45000(dyzetepesëmije)lekë

Skijim në pista të përcaktuara apo resorte skijimi(Ski)

Ski alpin ose skijim jashtë pistave të përcaktuara

apo resorteve të skijimit në terrene të thyera (Ski Touring)

Shtegëtim me Raketa Bore

MODULI 4 25000(njezetepesëmijë)lekë

Zhytje me bombul (Scuba Diving)

MODULI 5 25000(njezetepesëmijë)lekë

Udhëtim me makinë në terrene shumë të thyera (Off Road)

Në këtë tarifë janë nuk janë përfshirë shpenzimet për(Praktikën profesionale dhe Autodidakt)